

# DREJTËSIA

## DITARI MUJOR

### STRATEGJIA E PARË NDËRSEKTORIALE E MBROJTJES SË VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024 - 2030

LEXO PËR MË SHUMË



Prezantohet Strategjia e parë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit në Shqipëri. Ky është një hap i rëndësishëm në rrugën e integrimit evropian dhe një premtim i mbajtur nga angazhimi i vitit të kaluar. Manja shprehu falenderime për JUSTAL, Ministrin e Brendshëm, Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Prokurorin e Përgjithshëm, për angazhimet e marra për zbatimin e kësaj strategjie, që ka në themel mbrojtjen institucionale dhe trajtimin dinjitoz të viktimave të krimit. Bashkë, për një shoqëri me respekt dhe në mbrojtje të viktimave të krimit!

### NËNSHKRIMI I "MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT" NDËRMJET MINISTRISË SË DREJTËSISË, MINISTRISË ARSIMIT DHE SPORTIT DHE AMBASADËS ITALIAN

LEXO PËR MË SHUMË

Me "Marrëveshjen e Bashkëpunimit" që u nënshkrua u çel një kapitull i ri në luftën kundër korruptionit dhe edukimit të brezave te rinj mbi integritetin. Me Ogertën, Ministren e Arsimit dhe Sportit dhe me mbështetjen e pakushtëzuar dhe miqësore, të Ambasadës Italiane dhe mikut tonë të çmuar, ambasadorit Fabrizio Bucci, ky program do të aplikohet në 12 shkolla në 6 qytete të ndryshme, me vizionin që të prfshihet në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar.



### KONFERENCA RAJONALE "TË BASHKUAR KUNDËR DHUNËS - MJAFT", E MBAJTUR NË PRISHTINË

LEXO PËR MË SHUMË



Nisur edhe nga fati tragjik i Liridonës që tronditi të gjithë shqiptarët shpirtërisht, në konferencën rajonale "Të bashkuar kundër dhunës – Mjaft", Manja ndau me të ftuarit përqasjen dhe vëmendjen që shteti shqiptar i kushton parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje, me mekanizmat që kanë ndërtuar në ndihmë të viktimave dhe masave të repta ndëshkimore ndaj abuzuesve. Ministri Manja shprehu gjithashtu se qeveria Shqiptare ka treguar se është në lartësinë e kohës në këtë luftë, me fuqizimin që u ka bërë vajzave dhe grave në qeverisje dhe vendimmarrje, duke ju kundërvënë me forcë stereotipeve me bazë gjinore dhe duke ndërtuar një model edukues për të ardhmen. Dhuna me bazë gjinore dhe ajo në familje nuk është sjellje kulturore, por sjellje kriminale, dhe si e tillë duhet ndëshkuar! Është detyra jonë si prindër dhe si politik-bërës që brezave të ardhshëm të vajzave t'u ofrojmë siguri në çdo hap, theksoi ai!

### MANJA MIKPRET AMBASADOREN E RE TË FRANCËS NË SHQIPËRI ZNJ. CATHERINE SUARD SË BASHKU ME ZNJ. FRÉDÉRIQUE DUBOST, MAGISTRATEN NDËRLIDHËSE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

LEXO PËR MË SHUMË

Në këtë takim u bisedua për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, ekspertizën franceze për Institutin e të Miturve që do të ndërtohet në Tiranë, kontributin për forcimin e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës, por dhe për forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave!



### ME Z. SILVIO GONZATO, AMBASADORIN E RI TË BE-SË NË TIRANË

LEXO PËR MË SHUMË



Ky ishte një takim prezantimi dhe pune. U bisedua për sfidat dhe pritshmëritë e publikut nga drejtësia e re, si dhe hapat e ndërmarrë dhe ato që janë në agjendë për luftën kundër korruptionit. Manja shprehu se, si përherë, në këto sfida, do të kërkojmë të mbështetemi nga ekspertiza më e mirë e BE-së. Në përcjellje, një surprizë e këndshme qe takimi me skuadrën e mrekullueshme të Adeas, të gjithë kolegët e Ministrisë së Drejtësisë si institucion lider për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat themelore" pas përbilljes së suksesshme të procesit të shqyrimit analistik të legjisacionit me BE-në (screening)! Ministri shprehu mirënjoyje dhe falenderime për të gjithë! Puna vazhdon me ritme dhe më të larta në 2024!

### MBLEDHJA VJETORE E KOMITETIT TË BASHKËRENDIMIT TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

LEXO PËR MË SHUMË

Përgëzuam AIF (Agjencia e Inteligjencës Financiare) për punën e mirë dhe mirë-koordinimin institucional në luftën kundër pastrimit të parave. Pati diskutime dhe me masa konkrete në luftën kundër pastrimit të parave! Shqipëria vërtet doli nga lista gri, por duhet bashkëpunim dhe koordinim i përditshëm dhe i vazhdueshëm midis të gjitha agjencive me AIF, që të mos futemi përsëri në zonën gri!



Ministria e Drejtësisë  
Ulsi Manja



ministria\_drejtesise  
ulsimanja



@manja\_ulsi